



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 425 Prot.

Roskovec, më 19.02 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë 19 / 02 /2026

“PËR

**MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE
NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2026.”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 24, Ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM Nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij” dhe VKM Nr. 459, datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”,

Ju paraqesim për diskutim dhe miratim

1. Miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë për vitin 2026 për Bashkinë Roskovec.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi mesatar në zonat urbane (lekë pa tvsh)	Cmimi mesatar në zonat rurale (lekë pa tvsh)
1.	Banesa me qira	Muaj	1	10 000	-

	(apartament tip garzoniere)				
2.	Banesa me qira (Apartament 1+1)	Muaj	1	12 000	7000
3.	Banesa me qira (Apartament 2+1)	Muaj	1	15 000	10 000
4.	Banesa me qira (Apartament 3+1)	Muaj	1	17 000	12 000

2. Ngarkohet Komisioni i Strehimit për kryerjen e procedurave përkatëse:

Maksim Goga – Kryetar

Suela Cepele – Anëtar

Enkeleda Kola – Anëtar

Vjollca Zeqo – Anëtar

Edlira Toro – Anëtar

Eneida Hoxha – Anëtar

Ronada Hoxha – Anëtar

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

Konceptoi: *E.Kuqo*

Konfirmoi: *D.Hoxha*

Për Drejtorinë Juridike: *V.Zeqo*

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

KRYETAR

Majlinda Bufi

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Maksim Goga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 1485/Prot.

Roskovec, më 19.02 2026

Lënda: Relacion mbi projektvendimin për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë për vitin 2026.

KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC

Këtu!

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 8 dhe nenit 24 të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, pika 1 e nenit 38 të Ligjit Nr. 22/2018, “Për Strehimin Social”, dhe pika 4/a e VKM-së Nr. 362, datë 29.05.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”,

Në kuadër të detyrimeve dhe me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim, përmes subvencionimit të qirasë si instrument financiar i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë, duhet të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak vlera maksimale e subvencionit të qirasë, sipas nenit 38, pika 1 të Ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”. Këshilli i Ministrave, me Vendimin Nr. 362, datë 29.05.2019, pika 4/a, shprehet se për përcaktimin e vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, duhet ndër të tjera të përcaktohet edhe vlera mesatare e qirasë në tregun e lirë.

Në bazë të studimit të tregut testimit të tregut të lire i janë llogaritur vlerat mesatare të qirasë për të gjithë territorin e Bashkisë Roskovec , sipas strukturave të apartamenteve, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi mesatar në zonat urbane (lekë pa tvsh)	Cmimi mesatar në zonat rurale (lekë pa tvsh)
1.	Banesa me qira (apartament tip garzoniere)	Muaj	1	10 000	-

2.	Banesa me qira (Apartament 1+1)	Muaj	1	12 000	7000
3.	Banesa me qira (Apartament 2+1)	Muaj	1	15 000	10 000
4.	Banesa me qira (Apartament 3+1)	Muaj	1	17 000	12 000

Në këto kushte, me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e instrumentit financiar të subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, ju paraqesim për miratim projektvendimin:

Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë dhe të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2026.

1. Ngarkohet Komisioni i Strehimit për kryerjen e procedurave përkatëse:

Maksim Goga – Kryetar
Suela Cepele – Anëtar
Enkeleda Kola – Anëtar
Vjollca Zeqo – Anëtar
Edlira Toro – Anëtar
Eneida Hoxha – Anëtar
Ronada Hoxha – Anëtar

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

Konceptoi: *E. Kuqo*

Konfirmoi: *D. Hoxha*

Për Drejtorinë Juridike: *V. Zeqo*

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

K R Y E T A R

Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI
Maksim Goga

